



# SBASHK Arsimimi sot

Korrik, 2026

Gazeta elektronike

Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj dhe sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, u pritën nga ministri i Arsimit, Hajrulla Çeku

## SBASHK-u dhe MASH-i diskutojnë për sfidat dhe të ardhmen e arsimit



Ky takim, i cili ishte takimi i parë me Ministrin Çeku, u zhvillua në një frymë shumë miqësore dhe konstruktive. Kryetari Jasharaj, fillimisht, e uroi Ministrin për marrjen e detyrës së re dhe i dëshiroi suksese në përgjegjësinë e tij të rëndësishme në drejtimin e arsimit në Kosovë ... (faqe 4)

## SBASHK-u mori pjesë në Forumin Ndërkombëtar 'Istanbul EdUnion Forum 2026'



Në Forumin Ndërkombëtar 'Istanbul EdUnion Forum 2026', që ishte mbajtur në Stamboll nga 16 deri më 18 qershor 2026, kishte marrë pjesë edhe... (faqe 4)

## Ditët në bregdetin shqiptar



Duke vazhduar me traditën SBASHK edhe në verën 2026 dërgoi 450 pushues në bregdetin shqiptar ... (faqe 2)

## Intervistë me kryetarin e Shoqatës së Arsimitarëve të Turqve të Kosovës, z. Akif Koro



Shoqata e Arsimitarëve të Turqve të Kosovës e falënderon SBASHK-un për mbrojtjen e të drejtave të... (faqe 3)

## Zgjedhjet Sindikale në Dragash – Kryetar u rizgjedh Vloran Krasniqi



Sekretari i Përgjithshëm i SBASHK-ut, z. Ymer Ymeri, priti në takim përfaqësuesit e Shoqatës së Mësuesve Turq të Prizrenit: z. Akif Koro - Kryetar i Shoqatës së... (faqe 6)



## Editorial

### Ditët në bregdetin shqiptar



Duke vazhduar me traditën SBASHK edhe në verën 2026 dërgoi 450 pushues në bregdetin shqiptar. Të zgjedhurit nga institucionet arsimore, që nga çerdhet e deri në universitete e institucionet kulturore, kishin dëgjuar për Kompleksin Hotelier “Bonita” e disa kishin qenë aty me maurantët, por tani është ndryshe. Ata nuk janë të ngarkuar me detyra, por thjeshtë të relaksuar u bënë bashkë me valët e qeta të detit. Duke bashkëbiseduar me ta për ditët e pushimit të gjithë e thonë se ditët kanë ikur shpejt. Ata bëjnë fotografi me tërë grupin e pushuesve për ta ruajtur si kujtim nga ditët e kaluara në bregdetin shqiptar. Ata në shenjë respekti fotografohen edhe me kryeyarin e SBASHK-ut dhe me sekretarin e përgjithshëm dhe shprehin respekt për angazhimet e tyre dhe të stafit

qendror për mirëvajtjen e këtij aktiviteti. “Sikur të kishim edhe ndonjë ditë pushim” shprehen shumë nga ata duke shtuar se vërtetë kanë kaluar bukur dhe se ditët e pushimit po u iknin shpejt. Njëri nga pushuesit pasi u fotografua me kryetarin dhe sekretarin e përgjithshëm u tha se ka dëgjuar shumë herë për “Bonita”, por është hera e parë që ai vjen këtu. Ai për këtë falënderon SBASHK-un për këtë aktivitet shumë të qëlluar. Atmosferë e tillë ishte edhe në grupin e tretë të pushimit. Edhe atyre u kanë ikur shpejt ditët e pushimit. Ky aktivitet është bërë tradicional dhe në verën 2027, bregdetin shqiptar do ta vizitojnë 450 pushues të tjerë nga e tërë Kosova për t’u shoqëruar me valët e detit dhe për të ndjerë respektin dhe mikpritjen e pronarit dhe stafit të Kompleksit Hotelier “Bonita”.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel: +383 (0) 38 226 940





## Intervista

Shoqata e Arsimitarëve të Turqve të Kosovës e falënderon SBASHK-un për mbrojtjen e të drejtave të mësimdhënësve

### Mësimdhënësit turq të Kosovës kërkojnë sigurimin me kohë të teksteve shkollore dhe përmirësimin e tyre

Shoqata e Arsimitarëve të Turqve të Kosovës e cila funksionon për më shumë se 30 vite në Kosovë, numëron një numër të konsideruar të anëtarëve të saj, të cilët janë mësimdhënës të cilët punojnë në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë në gjuhën turke.

Kjo shoqatë ka ndihmuar ndër vite dhe shërben edhe si urë bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Turqisë në fushën e arsimit.

Mirëpo, ndër kërkesat e mësimdhënësve turq të Kosovës për institucionet e vendit, është sigurimi me kohë i teksteve shkollore në gjuhën turke si dhe përmirësimi i tyre.

Për më shumë informata rreth kësaj Shoqate, punëve dhe kontributit të saj në arsimin e Kosovës, mund të lexoni intervistën e realizuar me kryetarin e Shoqatës së Arsimitarëve të Turqve të Kosovës, Akif Koro.

**SBASHK:** I nderuar profesor Koro, ju jeni kryetar i Shoqatës së Arsimitarëve të Turqve të Kosovës. Cila është veprimtaria juaj?

**Koro:** Shoqata e Arsimitarëve të Turqve të Kosovës është themeluar në vitin 1994 dhe prej atëherë vepron në mënyrë aktive për zhvillimin dhe avancimin e arsimit në gjuhën turke në Kosovë. Anëtarë të shoqatës janë mësimdhënësit që punojnë në arsimin në gjuhën turke në të gjitha nivelet dhe në të gjitha rajonet e Kosovës.

Qëllimi ynë kryesor është të mbështesim si mësimdhënësit ashtu edhe nxënësit tanë. Organizojmë seminare, trajnime profesionale, konferenca, aktivitete kulturore dhe projekte edukative. Shoqata jonë shërben si urë bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Turqisë në fushën e arsimit.

**SBASHK:** Sa anëtar i ka Shoqata juaj dhe me çka merreni kryesisht?

**Koro:** Shoqata jonë ka rreth 250 anëtarë. Organizojmë trajnime profesionale, projekte arsimore e kulturore, përfaqësojmë interesat e mësimdhënësve dhe mbështesim nxënësit tanë.

**SBASHK:** Cilat janë kërkesat e arsimtarëve turq të Kosovës?

**Koro:** Kërkesat kryesore janë sigurimi me kohë i teksteve në gjuhën turke, organizimi i trajnimeve në gjuhën turke, përmirësimi i materialeve mësimore, shtimi i personelit mbështetës dhe mundësi të barabarta për zhvillim profesional.



**SBASHK:** Sa iu ka ndihmuar SBASHK-u?

**Koro:** Bashkëpunimin me SBASHK-un e vlerësojmë shumë. Ai ka kontribuar në mbrojtjen e të drejtave të mësimdhënësve, adresimin e kërkesave tona dhe organizimin e trajnimeve profesionale.

**SBASHK:** Cilat janë synimet e juaja?

**Koro:** Synimi ynë është ta forcojmë edhe më tej Shoqatën, të zgjerojmë bashkëpunimin me institucionet e Kosovës dhe Turqisë, të organizojmë më shumë seminare e projekte dhe të kontribuojmë në zhvillimin e arsimit në gjuhën turke.

## GJATË MUAJIT

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, u pritën nga ministri i Arsimit, Hajrulla Çeku

### SBASHK-u dhe MASH-i diskutojnë për sfidat dhe të ardhmen e arsimit



Kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj, i shoqëruar nga Sekretari i Përgjithshëm, z. Ymer Ymeri, u pritën në takim nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, z. Hajrulla Çeku, i shoqëruar nga Sekretarja e Përgjithshme, znj. Fadile Dyla dhe Drejtoresha e Arsimit Parauniversitar, znj. Anita Kadriu. Ky takim, i cili ishte takimi i parë me Ministrin Çeku, u zhvillua në një frymë shumë miqësore dhe konstruktive. Kryetari Jasharaj, fillimisht, e uroi Ministrin për marrjen e detyrës së re dhe i dëshiroi suksese në përgjegjësinë e tij të rëndësishme në drejtimin e arsimit në Kosovë.

SBASHK pritet nga kryetari i Komunës së Ferizajt, z. Agim Aliu

### Kryesia e SBASHK-ut zhvilloi takim me Kryetarin e Komunës së Ferizajt

Kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj, i shoqëruar nga sekretari i Përgjithshëm, z. Ymer Ymeri, anëtarja e Kryesisë së SBASHK-ut, znj. Hanife Salihu dhe kryetari i Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit (NSKAP) të Ferizajt, z. Arben Xhokli, u takuan me Kryetarin e Komunës së Ferizajt, z. Agim Aliu, dhe Drejtorin e Arsimit, z. Afrim Llabjani.

Në takim u diskutuan çështje të rëndësishme për arsimin, me theks të veçantë mungesa e kuadrove profesionale në lëndët ekzakte, kurrikula, Kontrata Kolektive dhe përmirësimi i kushteve të punës për mësimdhënësit.

Të dyja palët shprehën gatishmërinë për të vazhduar bashkëpunimin dhe koordinimin institucional në funksion të avancimit të arsimit dhe përmirësimit të pozitës së mësimdhënësve.

Gjatë takimit, Ministri Çeku i njoftoi përfaqësuesit e SBASHK-ut për planet dhe prioritetet e Ministrisë së Arsimit, si dhe për angazhimet që po ndërmerren në funksion të zhvillimit të sistemit arsimor. Ai shprehu gatishmërinë që SBASHK-u të jetë i përfshirë në komisionet dhe proceset e rëndësishme që lidhen me arsimin, përfshirë edhe hartimin e Strategjisë së re të Arsimit, e cila po përgatitet me angazhimin e ekspertëve vendorë, si dhe në çështje të tjera me rëndësi për arsimin dhe punëtorët arsimorë.

Në takim u diskutua edhe për trajnimin dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve, për mundësinë e bashkëpunimit të përbashkët ndërmjet Ministrisë, komunave, SBASHK-ut dhe prindërve, me qëllim të ngritjes së cilësisë në arsim, si dhe për planifikimin e mundshëm të mësimi tërëditor në shkollat nëntëvjeçare. Po ashtu, u bisedua për formulën e financimit dhe grantin specifik për arsimin, kontratat e punës, si dhe mundësitë për avancimin e arsimit të hershëm.

Në përfundim, të dyja palët vlerësuan rëndësinë e bashkëpunimit dhe të dialogut të hapur për adresimin e sfidave në sektorin e arsimit. Takimi u zhvillua në një frymë të veçantë miqësore dhe konstruktive dhe mund të konsiderohet si një fillim i mirë i një dialogu të ri dhe i një bashkëpunimi më të ngushtë ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe SBASHK-ut, në interes të mësimdhënësve, nxënësve dhe të ardhmes së arsimit në Kosovë.





## Sekretari i Përgjithshëm i SBASHK-ut, z. Ymer Ymeri, i pritë përfaqësuesit e Shoqatës Takim me përfaqësuesit e Shoqatës së Mësuesve Turq të Prizrenit



Sekretari i Përgjithshëm i SBASHK-ut, z. Ymer Ymeri, i pritë në takim përfaqësuesit e Shoqatës së Mësuesve Turq të Prizrenit: z. Akif Koro – Kryetar i Shoqatës së Mësuesve Turq, z. Ekrem Jilta – Sekretar i Shoqatës, dhe z. Orhan Volkan – Anëtar i Shoqatës.

Gjatë takimit u diskutua për shqetësimet dhe kërkesat e tyre lidhur me arsimin në gjuhën turke, përfshirë çështjet e teksteve dhe materialeve mësimore, përfaqësimit dhe përfshirjes së mësimeve të komunitetit turq, trajnimeve profesionale, si dhe çështje të tjera që lidhen

me pozitën e tyre profesionale dhe sociale.

Sekretari i Përgjithshëm i SBASHK-ut, z. Ymer Ymeri, i siguroi se SBASHK-u do t'i adresojë, brenda mundësive të veta, këto çështje pranë institucioneve përkatëse. Po ashtu, theksoi se në kuadër të programeve të trajnimeve të SBASHK-ut do të angazhohen edhe trajnerë nga komuniteti turq, në mënyrë që trajnimet për mësimeve të këtij komuniteti të zhvillohen në gjuhën turke, ashtu siç ka ndodhur edhe më parë në disa trajnime të organizuara nga SBASHK-u.

Gjithsej nën organizimin e SBASHK-ut këtë vit kanë pushuar 450 mësimeve nga e gjithë Kosova  
**SBASHK dërgoi në bregdet edhe mbi 200 mësimeve me grupin e tretë**



Nën organizimin e SBASHK-ut, në fillimkorrik kishin udhëtuar për në bregdetin shqiptar edhe mbi 200 mësimeve-anëtarë të Sindikatës, të cilët në shenjë respekti dhe mirënjohje për punën dhe kontributin në arsim, kishin qëndruar për një pushim 6 ditë atje.



Për këtë organizim, kryetari z. Rrahman Jasharaj i cili kishte qëndruar bashkë me pushues në bregdet, ishte shprehur i lumtur derisa mësimeve u kishte uruar pushime të këndshme dhe ditë të qeta në shoqërinë e kolegëve nga shkollat e tyre, komunat por edhe mbarë Kosova, të cilët e kishin shfrytëzuar këtë mundësi.





# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Me grupin e tretë dhe të fundit të pushuesve në bregdetin shqiptar, SBASHK-u e kishte përmbyll për këtë vit organizimin e pushimeve për mësimdhënës, duke rrumbullakësuar kështu një numër prej rreth 450 pushuesve të cilët e kishin shfrytëzuar pushimin në bregdet nën organizimin e SBASHK-ut, pa pagesë.



Paraprakisht në bregdet kishin udhëtuar edhe rreth 300 mësimdhënës në dy grupe të ndara, më 21 qershor 2026 grupi i parë dhe 26 qershor i dyti.




Mësimdhënësiut të cilët e kanë shfrytëzuar pushimin kolegjial në Durrës nën organizimin e SBASHK-ut, kanë lënë edhe përshtypjet e tyre

## Përshtypjet e pushuesve

Mësimdhënësit të cilët kanë pushuar në Durrës verën e 2026-ës nën organizimin e SBASHK-ut, janë shprehur të kënaqur, falënderues dhe shumë të respektuar nga Sindikata për këtë organizim.

Në librin e përshtypjeve ku janë shkruar me qindra mësimdhënës, kemi përzgjedhur disa nga ta dhe do t'i publikojmë në numrin e gazetës “Arsimimi Sot”, për t'i ndarë edhe me lexuesit tanë.

Një nga mësimdhënësit thotë se ishte kënaqësi për të që të qëndrojnë në shoqërinë e shumë mësimdhënësve nga e gjithë Kosova në një atmosferë të jashtëzakonshme.




kaluar disa ditë të mbushura me shoqëri, relaks dhe atmosferë të jashtëzakonshme. Gjatë gjithë qëndrimit, organizimi ishte në nivel të lartë dhe cdo gjë shkoi sipas planifikimit. Një falënderim i veçantë shkon për

SBASHK do të vazhdojë traditën në shërbim të anëtarësisë por edhe respektimin dhe mirënjohjen ndaj punës së paçmuar të mësimdhënësve të cilët kanë dhënë kontributin e tyre jetësor në edukimin e brezave dhe ngritjen e nivelit edukativ-arsimor në shoqëri.



udhëheqësen e grupit, znj. Njomza Sejdiu, e cila u tregua shumë e afërt, e komunikueshme dhe e gatshme për të ndihmuar në çdo moment. Përgëzime SBASHK për këtë organizim të shkëlqyeshëm dhe faleminderit për përvojën e bukur që na e mundësuar”, ka shkruar një nga pushuesit e grupit të parë, mësimdhënës në Prizren. Kurse, një mësimdhënës tjetër nga Skenderaj thotë se është kënaqësi të jesh pjesë e SBASHK-ut si dhe arsimit në përgjithësi.



“Ishte një përjetim shumë i mirë. Kaluam çaste të mrekullueshme në hotel Bonita, me një udhëheqëse të jashtëzakonshme të grupit si Njomza. Me të vërtetë është kënaqësi të jesh pjesë e SBASHK-ut dhe arsimit në përgjithësi.

Momente që do të jenë gjatë në kujtesën time”, ka shkruar ndër të tjera mësimdhënësi nga Skenderaj.

Përshtypjet e tyre nga Peja i ka dhënë përmes një shkrimi edhe grupi i mësimdhënësve të këtij qyteti, ku ndër të tjera kënë shkruar se pushimi nën organizimin e SBASHK-ut në Durrës, për ta do të mbetet eksperiencia më e bukur e jetës.





Jemi pjesë e grupit të pushuesve nga Peja. Kemi përshtypjet më të mira gjatë këtyre ditëve që nga nisja e udhëtimit e çdo gjë tjetër gjatë këtyre pesë ditëve. Patëm mundësi të shoqërohemi edhe me kolege të qyteteve dhe shkollave hera. Për ne si grup do të mbetet eksperiencë me e bukur e jetës. Me respekt: Grupi nga Peja

“Jemi pjesë e grupit të pushuesve nga Peja. Kemi përshtypjet më të mira gjatë këtyre ditëve që nga nisja e udhëtimit e çdo gjë tjetër gjatë këtyre pesë ditëve. Patëm mundësi të shoqërohemi edhe me kolegë të qyteteve tjera. Për ne si grup do të mbetet eksperiencë më e bukur e jetës. Me respekt: Grupi nga

Peja, përfundon përshtypja e këtyre mësimdhënësve. SBASHK përfaqëson edhe mësimdhënësit shqiptar të Luginës, ku një pjesë e tyre po ashtu çdo vit marrin pjesë në pushimet e organizuara në bregdetin shqiptar, e të cilët e vlerësojnë lartë këtë angazhim të SBASHK-ut. Një pushues nga Bujanoci thotë se është i nderuar për mikpritjen e SBASHK-ut në organizimin e pushimeve për mësimdhënësit anëtar.

Përshtypja e pushimit në Durrës organizuar nga SBASHK. RE Kamenicë. Një miqësor pushim i legjionit prejorës. - Kamenica e Bujanocit. Jemi të nderuar dhe mikpritur në të gjitha përvojat tona. Jemi shumë falënderues për organizimin e të gjitha, ky do të jetë kujtim i paharshëm nga unë dhe ti. Me respekt. 26.06.2025

“Ne si përfaqësues të Luginës së Preshevës, Komuna e Bujanocit, jemi të nderuar dhe privilegjuar tej mase për mikpritjen tuaj, jemi shumë falënderues si në organizimin dhe gjithë mbarëvajtjen e këtij pushimi. Ky do të jetë kujtim i

përhershëm nga ne”, ka shkruar pushuesi nga Bujanoci. Edhe nga Gjilani kishte përshtypje të mira dhe falënderime për pushimet e organizuara nga SBASHK-u.

Një pushim i organizuar nga SBASHK për dy puntoret e kësaj shoqate, ishte një pushim i mirëseardhur dhe në kohën e duhur. Me një organizim të mirë dhe ambient të mrekullueshëm në Hotelin Bonita dhe mikpritje nga stafi. Falënderim i pafund nga organizatorët dhe mikpritësit. 01.07.2026 - 06.07.26 Blunat.

“Një pushim i organizuar nga SBASHK-u për dy puntoret e kësaj shoqate ishte një pushim i mirëseardhur dhe në kohën e duhur. Me një organizim të mirë dhe ambient të mrekullueshëm në hotelin Bonita dhe mikpritje nga stafi. Falënderim i pafund nga organizatorët dhe mikpritësit”, kanë shkruar dy pushuese nga Gjilani.

Kurse përshtypje të mira dhe falënderime kanë shprehur edhe nga shkollat e Kaçanikut dhe Kamenicës.

Gjimnazi "SKENDERBEGU" KAGANIC SA I PËRKET PUSHIMIT SHUMË MIRË JEMI I FALËNDERUES SINDIKATËS JEMI SHUMË TË KËNAQUR RESPEKT R. R.

“Sa i përket pushimit shumë mirë, jemi falënderues Sindikatës, jemi shumë të kënaqur”, ka shkruar një pushues nga Kaçaniku.

SHKOLLA FILLORË FAN NOLI KAMENIC Përshtypjet e mia janë shumë të mira si akomodimi ushqimi plazhi të gjitha kushtet janë fenomenale. Bimthani

“Përshtypjet e mia janë shumë të mira që nga akomodimi, ushqimi, plazhi, të gjitha kushtet janë fenomenale”, ka shkruar një pushues nga Kamenica.

